



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 284 Prot.

Tiranë, më 08.02.2022

V E N D I M

Nr. 35, Datë 08.02.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 102 regj, datë 02.06.2021, të paraqitur nga subjekti ankues, P. B², kundër Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale/³ pranë Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës, etnisë⁴” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, P. B, është prind i tre fëmijëve: dy vajzave F dhe M. B përkatësisht të moshave 7 dhe 12 vjeç, të cilat jetojnë në “Shtëpinë e Fëmijës” Sarandë, dhe një djali A. B, i moshës 5 vjeç, i cili jeton në “Shtëpinë e Fëmijës”, Vlorë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Dhënë miratimin pranë KMD-së, për t’u përfaqësuar në këtë proces administrativ nga “Qendra për të Drejtat e Gruas Rome”.

³ Në vijim DPSHS/Bashkia Tiranë

⁴ Referuar dokumentit, Vërtetim i datës 01.06.2021 të lëshuar nga organizata “Qendra për të Drejtat e Gruas Rome”, ankesja rezulton se është anëtare e minoritetit Rom të Shqipërisë.

Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke e përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b).

⁵ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

Ankuesja shprehet se për shkak të situatës së vështirë ekonomike, ishte e detyruar të dilte të lypte në rrugë, bashkë me fëmijët, pasi bashkëshorti ishte i dënuar me burgim dhe nuk kishte mundësi tjetër për të siguruar të ardhura për familjen.

Znj. B informon se para 4 vitesh, Shërbimet Sociale/Bashkia Tiranë, i kanë marrë fëmijët dhe i kanë dërguar në shtëpitë e fëmijës në qytetet Vlorë dhe Sarandë, për shkak se e kanë gjetur duke lypur në rrugë bashkë me ta.

Në momentin që bashkëshorti ka dalë nga burgu, kanë punuar të dy në punë të ndryshme informale: shitje rrobash të përdorura, mbledhje hekurishtesh, etj, në mënyrë që të mund të krijonin të ardhura dhe të siguronin një banesë me qira, që të merrnin fëmijët sërish në shtëpi.

Ankuesja shprehet se kanë hasur vështirësi të mëdha, përsa i takon faktit të gjetjes së një banese të përshtatshme me qira, dhe një pune të rregullt, pasi duke qenë pjesëtarë të minoritetit rom paragjykohe dhe nuk arrijnë të gjejnë një punë të qëndrueshme dhe se pronarët e banesave nuk iu bëjnë kontrata qiraje të noterizuara, siç kërkohen nga Shërbimet Sociale/Bashkia Tiranë.

Znj. B ka pretenduar se, nga ana e Shërbimeve Sociale/Bashkia Tiranë nuk u është ofruar asnjë ndihmë lidhur me pagesën e qirasë së shtëpisë apo ndonjë bonus tjetër, dhe as lidhur me punësimin e tyre, në mënyrë që të rimerrnin fëmijët e tyre.

Ankuesja informon Komisionerin, se për shkak të pamundësisë ekonomike dhe distancës së qyteteve ku janë fëmijët e ka të pamundur t'i takojë dhe të ruajë kontaktet prind-fëmijë me ta. Ajo kërkon që fëmijët të kthehen në familje dhe të rriten me prindërit e tyre.

Në përfundim të ankesës, P. B, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e problematikës së saj me anë të ndërmjetësisimit, për marrjen e masave nga ana e Shërbimit Social, pranë Bashkisë Tiranë për rikthimin e fëmijëve pranë familjes.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Shkaqet e pretenduara nga ankuesja, janë shkaqe të mbrojtura nga neni 1, i ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 839/1 prot., datë 14.06.2021 Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrimet, DPSHS pranë Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Tiranë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Nëpërmjet shkresës me nr. 759/1 prot., datë 24.06.2021, DRSHSSH Tiranë, ka njohur Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra në kuadër të problematikës së ankueses P. B, duke parashtruar si më poshtë vijon:

“Familja B. ka qenë një familje lëvizëse dhe në periudha të ndryshme kohore ka jetuar në territorin e njësisë administrative nr. 8 dhe me gjendje civile në njësinë administrative nr. 6, në Tiranë. Në muajin nëntor 2017 ka kryer martesë fiktive në Berat dhe i janë ndërprerë të gjitha pagesat pranë njësisë administrative nr. 6. Nga verifikimi në Regjistrin Elektronik të Ndhmës Ekonomike, rezulton se ka qenë përfituese e pagesës në shumën 12.000 lekë në muaj, si kategori e veçantë me status jetimi vetë ankuesja, pasi ka qenë nën moshën 25 vjeçe që parashikon ligji, si dhe tre fëmijët e saj: F, M, dhe A. B deri në muajin dhjetor 2017, ku dhe u ka mbaruar afati i vlefshmërisë. Nëna shpeshherë ka ndryshuar vendndodhjen duke mos patur një adresë të saktë dhe nga informacionet e marra nga aktorët e përfshirë në procesin e menaxhimit, nga specialistët e mbrojtjes së fëmijëve, të cilët kanë menaxhuar rastin në periudha të ndryshme, rezulton se nëna ka patur problem me neglizhimin e fëmijëve të saj ndër vite dhe ka një historik të hershëm të fëmijëve në situatë rruge.

Më datë 24.08.2018, nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) i njësisë nr. 8, është mbledhur Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN), ku në bazë të vlerësimit të gjendjes së saj në situatë rruge ka propozuar “Masë mbrojtëse për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar” për të katër fëmijët, ku sapo kishte sjellë në jetë dhe djalin e vogël. Propozimi ishte për “mbikëqyrje të specializuar”, pasi rasti nuk kishte një ecuri të mirëfilltë menaxhimi pas largimit nga Tirana dhe duheshin parë shkaqet pse fëmijët kanë ushtruar lypje. Gjithashtu u vendos për fuqizimin e familjes përmes mbështetjes me programet e kujdesit social dhe regjistrimi i fëmijës së porsalindur në Gjendjen Civile.

Më datë 4 tetor 2018, ankuesja është identifikuar përsëri në situatë rruge me tre fëmijët dhe në momentin që ka vajtur skuadra e terrenit së bashku me policinë, nëna është larguar.

Më datë 14 dhjetor, foshnja e vogël e ankueses ndërron jetë dhe PM I njësisë 8 dhe PMF i njësisë Dajt kanë asistuar dhe ndihmuar në të gjitha procedurat për varrimin e foshnjës.

Më datë 16 janar 2019 nga PMF i njësisë 8, është mbledhur GTN për znj. B. Gjatë takimit u diskutua mbi historikun e familjes, shërbimet e ofruara, aktorët e përfshirë në proces, masat e ndërmarra nga gjithësecili. Mbështetur në fakte dhe argumente mbi situatën e znj. B dhe fëmijëve të saj, nga muaji maj 2017 deri në janar 2019, aktorët ngritën shqetësimin për mirëqënien fizike, psikologjike, emocionale të fëmijëve, nëse ata do të qëndronin në banesën aktuale së bashku me nënën dhe GTN ka propozuar “masën e mbrojtjes për vendosjen e tre fëmijëve në përkujdesje alternative”.

Gjithashtu GTN vendosi:

- Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes (PIM) për çdo fëmijë;
- Fuqizimin e nënës përmes programeve të strehimit social të ofruar nga Bashkia Tiranë;
- Komisariati i Policisë nr. 4, do të asistojë strukturën sociale të njësisë administrative nr. 8 Tiranë, me aktorët prezent, për ekzekutimin e vendimit “Masë Mbrojtje” për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative.
- TLAS do të asistojë nënën në ndjekjen e të gjitha proceseve ligjore të divorcitet;

- Të gjithë aktorët dolën në konkluzion se do të ishte në interesin më të lartë të fëmijëve akomodimi i tyre në institucionet rezidenciale “Hanna dhe Rozafa” dhe shtëpia e fëmijës “Zyber Hallulli”, që ndodhen në Tiranë.
- PMF i njësisë 8, së bashku me gjithë aktorët prezent në takim, do të ndjekë të gjitha procedurat dhe hapat për ekzekutimin e masës, akomodimin e fëmijëve dhe përgatitjen e gjithë dokumentacionit të parashikuar.
- Më datë 02.06.2021, është zhvilluar takimi i GTN për fëmijët B, i thirrur nga PMF i njësisë 8, në të cilin është diskutuar për shërbimet që ka përfutur Pavlina gjatë periudhës që fëmijët janë vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe ecuria e rastit. Nëna ka interesim për fëmijët dhe kërkon t’i marrë në familje, por për shkak të neglizhimit, paqëndrueshmërisë së saj dhe kushteve të vështira ekonomike, nuk ka arritur t’i marrë ata përfundimisht. Asaj iu bë e ditur se për të rimarrë fëmijët nuk mjafton vetëm dëshira e madhe, por duhen përmbushur disa kushte si: punësimi dhe strehimi i qëndrueshëm. Do të ndiqen me rigorizitet të gjitha procedurat për përfitim të shërbimeve. Grupi teknik doli me një vendim për hapat që do të ndiqen më tej, të cilat janë pasqyruar në minutat e takimit, ku secili aktor do të ndjekë detyrat që ka marrë përsipër”.

Nëpërmjet shkresës me nr. 23991/1 prot., datë 25.06.2021, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale/⁶Bashkia Tiranë, ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj, përsa i takon pretendimeve të ankueses.

DPSHS/Bashkia Tiranë, informon Komisionerin se: “Mbrojtja, respektimi dhe promovimi efektiv i të drejtave të fëmijëve është një nga prioritetet e Bashkisë Tiranë, të cilat realizohen përmes ndërhyrjeve konkrete, që nga procesi i planifikimit të politikave vendore, ngritjen e strukturave, programeve dhe shërbimeve direkte me synim përmirësimin e cilësisë së jetesës sidomos për kategoritë më në nevojë, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Në kuadër të marrjes së masave që fëmijët të mos qëndrojnë në rrugë, Bashkia Tiranë ka ngritur strukturat kyçe për parandalimin, mbrojtjen, fuqizimin dhe riintegrimin e fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve të tyre, duke realizuar ndërhyrje konkrete”.

Lidhur me masat e marra për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge, DPSHS/Bashkia Tiranë, ka informuar si më poshtë vijon:

“Menaxhimi i rastit është një metodologji që siguron hap pas hapi ofrimin e vazhdueshëm e efektiv të ndihmës për individët në nevojë (fëmijë, të rritur apo familje) dhe synon të promovojë e të nxitë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e personit. Menaxhimi i rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve mbështetet dhe drejtohet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, mbështetet në nevojat e tij, ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe bashkëpunimin e ngushtë mes aktorëve të ndryshëm, që kanë një ndikim në jetën e fëmijës, përfshirë prindërit, mësuesit, personelin shëndetësor, anëtarë të tjerë të familjes, etj.

⁶ Në vijim DPSHS/Bashkia Tiranë

Çdo njësi administrative ka një PMF, i cili, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimi, gjatë hartimit, si dhe zbatimin e masës së mbrojtjes deri në përfundimin e saj. Pas identifikimit të rastit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve kryen vleresimin e nivelit të rrezikut, kërkon mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe harton planin individual të mbrojtjes për fëmijën, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes. Më pas informon drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe i propozon drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masës së mbrojtjes mbi bazën e PIM, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan.

Gjatë viti 2020, PMF-të, kanë menaxhuar në total 533 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nga të cilat 185 janë raste të reja, identifikuar dhe menaxhuar për herë të parë gjatë 2020. Problemet social-ekonomike përbëjnë problematikën kryesore të identifikuar në rastet në process menaxhimi (194 raste) dhe rastet e fëmijëve në rrugë (120 raste).

I gjithë procesi i menaxhimit të rastit është i rregulluar me VMK nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, dhe për rastet e fëmijëve në situatë rruge janë ngritur në PIM të cilat parashikojnë si ndërhyrje dhe shërbime kryesore:

- Vizita në familje dhe vlerësime psikologjike, sociale dhe ekonomike;
- Mbështetje me paketa ushqimore;
- Veshmbathje;
- Paketa higjeno-sanitare;
- Pagesë qiraje;
- Lidhja e kontratave noteriale;
- Medikamente;
- Ndërmjetësim për punësim;
- Shërbim psiko-social;
- Ndihmesë në përgatitjen e dokumentave për bonus qiraje;
- Ndërmjetësim dhe asistim në kryerjen e vizitave mjekësore;
- Regjistrim në çerdhe, kopështe, shkolla;
- Regjistrim në Gjendjen Civile;
- Shërbim ligjor falas.

Lidhur me statistikat e rasteve të fëmijëve në situatë rruge, për katër vitet e fundit në Bashkinë Tiranë, DPSHS/Bashkia Tiranë, ka referuar këto statistika, respektivisht si më postë citohet:

Për vitin 2017 – 184 raste;

Për vitin 2018 – 150 raste;

Për vitin 2019 – 136 raste;

Për vitin 2020 – 120 raste.

Lidhur me masat e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për trajtimin dhe zgjidhjes së problematikës së ankueses, DPSHS/Bashkia ka informuar, ndër të tjera, si më poshtë:

“Në vitin 2020, në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit, rasti është rihapur me qëllim fuqizimin e familjes biologjike dhe rikthimin e fëmijëve në familje.

Menjëherë pas referimit është realizuar një vizitë në familjen e znj. B, ku u vlerësua se familja jeton në një banesë me qira, në zonën e Bregut të Lumit, me vlerë prej 12.000 lekësh në muaj. Banesa, nisur nga vlerësimi, është e përshtatshme për jetesë, me hapësira të mjaftueshme, por sipas znj. P, qiraja është e papërbalueshme nga ana e saj. Nga biseda e realizuar me të, ajo i përballon shpenzimet me pagesën që merr nga shitja e rrobave, ku një pjesë të të ardhurave shprehet se i përdor për shpenzimet e përditëshme, kurse pjesën më të madhe i kursen. Aktualisht znj. B jeton me bashkëjetuesin e saj, me të cilin nuk ka lidhur martesë por që shprehet se dëshiron të lidhë celebrim me të. Lidhur me fëmijët, ajo kërkon që ata të rikthehen në familje dhe sipas saj ajo ka kushtet e nevojshme për mirërritjen e fëmijëve.

Mbledhja e GTN për fëmijët e znj. B u realizuar më datë 03.02.2021, ku u hartua dhe një PIM 1-mujor për fuqizimin e familjes. Pas kësaj date, znj. B u largua në Berat dhe rasti u referua në strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në Bashkinë Berat.

Më datë 02.06.2021, znj. B është paraqitur pranë PMF në njësinë administrative nr. 8, Tiranë dhe dosja është rihapur sërish.

Në këtë GTN u rivlerësuan kushtet social-ekonomike të familjes dhe u dol me vendimin:

- *Do mundësohet regjistrimi i znj. B si shitëse ambulante - Qendra “Për të Drejtat e Gruas Rome”.*
- *Rishikimi i mundësisë për të nëshkruar kontratë huapërdorimi ose gjetjen e një shtëpie me kontratë qiraje - Qendra “Për të Drejtat e Gruas Rome”.*
- *Monitorim i vazhdueshëm – Nisma, PMF njësia 8.*
- *Pas zbatimit të planit në varësi të vlerësimeve do të ndërmerren hapa të mëtejshëm për rikthimin e fëmijëve në familje.*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, më datë 25.08.2021 zhvilloi seancën dëgjimore⁷.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces. Ankuesja u përfaqësua në këtë seancë nga M. V, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës “Për të Drejtat e Gruas Rome”. DPSHS/Bashkia Tiranë u përfaqësua nga: S.K, J. K⁸, dhe A. Gj, ndërsa DRSSH Tiranë u përfaqësua nga E. P.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen, gjatë arsyetimit të vendimit.

⁷ Referuar shkresës me nr. 839/4 prot., datë 14.07.2021ë Komisionerit.

⁸ Mbështetur në shkresën me nr. 28339/2 prot., datë 31.08.2021, të DPSHS/Bashkia Tiranë.

Lidhur me pretendimet e ngrituara nga përfaqësuesja e ankueses, përsa i takon dyshimeve se fëmijët e P. M në shtëpitë e përkujdesjes janë ngacmuar seksualisht apo pretendimit se ankuesja kërkon që ata të transferohen në shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli”, në Tiranë, Komisioneri i bëri të njohur të drejtën për t’i paraqitur pranë organeve kompetente, si: prokuroria apo gjykata, pasi akuza të tilla përbënin dyshime për elementë të veprës penale, dhe nuk janë në kompetencën e Komisionerit shqyrtimi dhe vendimmarrja lidhur me pretendime të tilla. Po ashtu, pretendimet për transferimin e fëmijëve nuk kanë qenë objekt shqyrtimi i kësaj ankese dhe Komisioneri nuk mund të shprehet për një pretendim të pa shqyrtuar dhe hetuar më parë, dhe se po ashtu duhej ndjekur procedura përkatëse, duke paraqitur kërkesat specifike fillimisht pranë institucioneve kompetente për shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre.

Palëve iu bë e njohur e drejta për të paraqitur pranë KMD-së, prova apo parashtrime të tjera shtesë lidhur me pretendimet e tyre.

Përfaqësueset e DPSHS/Bashkia Tiranë lanë të hapur mundësinë e rivlerësimit të rastit të ankueses, si dhe dërgimin e informacionit lidhur me masat e ndërmarra prej tyre në vijim të seancës.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 3644 prot., datë 21.09.2021, DPSHS/Bashkia Tiranë, informoi Komisionerin se:

“Bashkë me dokumentacionin bashkëlidhur shkresës, ku evidentohen shërbimet e marra nga znj. B, ju bëjmë me dije se, rasti nuk menaxhohet më nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve (SMF) pranë Bashkisë Tiranë, pasi është transferuar në qytetin e Shkodrës”; si dhe depozitoi kopje të dokumentacionit të kërkuar, i cili do të shtjellohet gjatë vendimit.

4. Nëpërmjet e-mailit datë 03.11.2021, përfaqësuesja e subjektit ankues ka informuar Komisionerin se, informacion i dërguar se ankuesja banon në Shkodër është i pasaktë, pasi ajo ka vajtur për vizitë atje, e jo për të jetuar. Po ashtu, ka informuar dhe se nga aktorët e përfshirë në këtë proces janë ndërmarrë hapa konkrete lidhur me sistemimin e ankueses në një banesë me qira dhe se gjithashtu, po ndërmjetësohej për punësimin e saj, dhe në këto kushte, ka kërkuar nga Komisioneri të marrë në konsideratë dokumentacionin që do dërgonin në vijim.

Bazuar në informacionin e dërguar nga përfaqësuesja e ankueses, në faktin që P. B vijon të jetë aktualisht banore e qytetit të Tiranës, duke u nisur nga natyra komplekse dhe delikate e rastit, fakteve të pretenduara, objekti i çështjes, si dhe në mbrojtje të parimit të interesit më të lartë të fëmijëve, Komisioneri vlerëson se, jemi përpara një problematike me natyrë komplekse dhe për rrjedhojë, duhet të kryejë veprime të tjera hetimore lidhur me informacionin e ri nga pala ankuese, provat e sjella dhe verifikimin e tyre .

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, është theksuar fakti se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje

kohore të konsiderueshme (shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, vendimin nr. 16, datë 16.03.2021, vendimin nr. 22, datë 29.04.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 92⁹ i Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikon se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit”.

5. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vendosi të zgjasë afatet procedurale për shqyrtimin e ankesës me nr. 102 regj, datë 02.06.2021, për 90 ditë të tjera dhe t'i kërkojë DPSHS/Bashkia Tiranë të depozitojë parashtrime dhe dokumentacion provues shtesë, lidhur me masat e ndërmarra në kuadër të zgjidhjes së problematikës së ankueses për banesën me qira, si dhe punësimin e saj (Vendimi nr. 228, datë 22.11.2021, i KMD-së).

6. Nëpërmjet shkresës me nr. 46700/1 prot., datë 07.12.2021, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Tiranë, ka informuar Komisionerin se:

“...Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, pasi është informuar në lidhje me Njësinë Administrative ku është vendosur znj. B dhe bashkëjetuesi i saj, i ka bërë me dije se do të caktohet një punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve për t'i bërë rivlerësimin e kushteve të jetesës, përcaktimin e nevojave si dhe rishqyrtimin e planit të fuqizimit për ofrimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme me qëllim deinstitucionalizimin e fëmijëve të saj.

Gjithashtu, znj. B dhe bashkëjetuesi i saj, kanë marrë përsipër se do të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për transferimin e gjendjes civile në një prej njësive administrative të qytetit të Tiranës, me qëllim përfitimin e paketës së shërbimeve, përfshirë këtu bonusin e qirasë që Bashkia e Tiranës ofron për kategoritë në nevojë që janë banorë të kësaj Bashkie.

Sqarojmë se ndjekja dhe fuqizimi i rastit në fjalë ka hasur në vështirësi dhe problematika nga punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve të cilët kanë menaxhuar rastin, për shkak të lëvizjeve të shpeshta të familjes dhe humbjes së kontakteve me ta”.

7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1321 prot., datë 19.01.2022 (pranë KMD-së) subjekti ankues paraqiti pranë Komisionerit, kërkesën e saj dërguar Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Tiranë, në të cilën citohet si më poshtë:

“Po ju drejtohem me këtë kërkesë për të më kthyer fëmijët të cilët prej 3 vitesh qëndrojnë në institucion në Sarandë. Nga ana ime kam bërë të gjitha përpjekjet për të ndryshuar situatën time.

⁹ “Zgjatja e afatit të procedurës”.

Tani unë jetoj në Selitë, afër shkollës “26 Nëntori” dhe në fillim të dhjetorit 2021 kam filluar punë në kompaninë e pastrimit “Fusha”. Aktualisht bashkëjetoj me Q. M, babain biologjik të fëmijëve të mi, i cili ka 3 muaj që është punësuar pranë kompanisë së pastrimit në Sharrë.

Nga ana e Shërbimeve Sociale pranë Njesisë nr.8, Tiranë nuk është bërë asgjë për të më ndihmuar, përkundrazi më kanë neglizhuar. Qendra “Për të Drejtat e Gruas Rome” më ka ndihmuar dhe për t’u punësuar, por gjetja e një shtëpie me qira, me kontatë të rregullt mbetet akoma shumë e vështirë për arsye se pronarët nuk pranojnë të bëjnë kontratë qiraje. Madje, shpesh refuzojnë të na japin shtëpinë me qira sepse na paragjykojnë se jemi romë. Ju lutem të merrni në konsideratë përpjekjet e bëra nga unë dhe të më ktheni fëmijët”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar dhe vlerësuar trajtimin që Bashkia i ka bërë ankueses në raport me të drejtat e saj ligjore.

A.1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, se është trajtuar në mënyrë të padrejtë, e të pafavorshme nga ana e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Njesisë Administrative nr. 8, pranë Bashkisë Tiranë, përsa i takon neglizhencës në marrjen e masave për fuqizimin ekonomik-social të familjes së saj.

Nga analizimi i situatës, si dhe referuar kronologjisë së ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton se, familja B ka një historik të hershëm të fëmijëve të identifikuar në situatë rruge. Fillimisht kjo familje është identifikuar nga Policia Bashkiake Tiranë, në situatë rruge me fëmijët në muajin maj të vitit 2017.

Referuar të dhënave e provave të administruara në kuadër të shqyrtimit të ankesës, evidentohet se ankuesja dhe fëmijët e saj, gjatë vitit 2017-2018, janë zhvendosur herë pas herë nga një njësi administrative në tjetrën brenda territorit të Bashkisë Tiranë, apo nga Tirana në Berat dhe në Shkodër.

Nga muaji prill 2018 evidentohet se familja B është rikthyer për të jetuar sërish në Tiranë.

Më datë 24.08.2018, nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) i Njesisë Administrative nr. 8, është mbledhur Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN), ku në bazë të vlerësimit të gjendjes së saj në situatë rruge ka propozuar “Masë mbrojtëse për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar”

për të katër fëmijët, ku sapo kishte sjellë në jetë dhe djalë e vogël. Propozimi ishte për “mbikëqyrje të specializuar”, pasi rasti nuk kishte një ecuri të mirëfilltë menaxhimi pas largimit nga Tirana dhe duheshin parë shkaqet pse fëmijët kanë ushtruar lypje. Gjithashtu u vendos për fuqizimin e familjes përmes mbështetjes me programet e kujdesit social dhe regjistrimi i fëmijës së porsalindur në Gjendjen Civile.

Pas arrestimit të bashkëjetuesit të ankueses, ajo e ka patur të pamundur të paguajë qiranë e banesës ku jetonte dhe së bashku me fëmijët është gjendur në situatë rruge. Pasi është informuar lidhur me situatën e znj. B, punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve nr. 8, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve, kanë mundësuar largimin e familjes nga territori i Njesisë Administrative nr. 9, duke i sistemuar pranë rulotave në Tufinë. Nga ana e Agjencisë Shtetërore i është ofruar mundësia e sistemimit të saj dhe fëmijëve në një qendër në qytetin e Lushnjës, deri sa familja të fuqizohej, ofertë të cilën ankuesja nuk e ka pranuar.

Më datë 4 tetor 2018, ankuesja është identifikuar përsëri në situatë rruge me tre fëmijët.

Më datë 14 dhjetor, foshnja e vogël e ankueses ka ndërruar jetë dhe PMF i njesisë 8 dhe PMF i njesisë Dajt kanë asistuar dhe ndihmuar në të gjitha procedurat për varrimin e foshnjës.

Më datë 16 janar 2019 nga specialisti i MF i njesisë 8, është thirrur dhe mbledhur GTN për znj. B. Bazuar në procesverbalin e takimit rezultoi se gjatë këtij takimi është diskutuar mbi historikun e familjes, shërbimet e ofruara, aktorët e përfshirë në proces, masat e ndërmarra nga gjithësecili prej tyre. Mbështetur në fakte dhe argumente mbi situatën e znj. B dhe fëmijëve të saj, GTN ka propozuar “Masën e mbrojtjes për vendosjen e tre fëmijëve në përkujdesje alternative”.

Në vijim, Njësia Administrative nr. 8, pranë Bashkisë Tiranë, ka paraqitur para Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështjen me objekt “Vlefshmëri për masën e mbrojtjes “Vendosje në përkujdesje alternative, pranë një institucioni rezidencial të përkujdesjes për fëmijët F, M dhe A. B”.

Me vendimin datë 25.01.2019, Gjykata, ndër të tjera, ka vendosur:

“Të vlerësojë të ligjshëm masën e mbrojtjes të marrë me Vendimin nr. 2468/1 prot., datë 17.01.2019, nga Drejtoria e Shërbimit Social/Bashkia Tiranë “Masë e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative”, pranë një institucioni rezidencial të përkujdesjes për fëmijët M, A dhe F. B.

Vendosjen e fëmijës F. B në përkujdesje alternative pranë Shtëpisë së Fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.

Vendosjen e fëmijëve M dhe A. B në përkujdesje alternative pranë Shtëpisë së Foshnjës Vlorë.

Ky vendim, ka të njëjtat efekte si vendimi gjyqësor për kujdestarinë. Këto institucione kanë të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes.

Ky vendim, është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit për vendosjen e fëmijës në kujdestari sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes të konfirmuar nga Gjykata, nëna e tyre P. B nuk mund të ushtrojë përgjegjësinë prindërore”.

Në kuadër të masave të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë për të trajtuar zgjidhjen e problemtikës së subjektit ankues, pas vendosjes së fëmijëve të saj në përkujdesje

alternative pranë shtëpive të fëmijës në Sarandë dhe Vlorë, (në parashtrimet e sjella nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Tiranë, është theksuar se në vitin 2020, në kuadër të procesit të deinstitucionalizimit), rasti është rihapur me qëllim fuqizimin e familjes biologjike dhe rikthimin e fëmijëve në familje.

Referuar vlerësimit të bërë nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, lidhur me monitorimin e menaxhimin e këtij rasti, evidentohet se, ata kanë dalë në konkluzionin se, familja jeton në një banesë me qira në zonën e Bregut të Lumit, me vlerë prej 12 000 lekësh në muaj dhe se, banesa, nisur nga vlerësimi, është e përshtatshme për jetesë, me hapësira të mjaftueshme. Nga biseda e realizuar me ankuesen, ka rezultuar se ajo i përballon shpenzimet me pagesën që merr nga shitja e rrobave, ku një pjesë të të ardhurave është shprehur se i përdor për shpenzimet e përditshme, kurse pjesën më të madhe i kursen. Lidhur me fëmijët ajo ka kërkuar që të rikthehen në familje, pasi i ka kushtet e nevojshme për mirërritjen e tyre.

Në kuadër të projektit Advancing Child Protection and Care in Albania 2019-2021 (me kohëzgjatje projekti nga muaji mars 2019-dhjetor 2021), Bashkia dhe shoqata “Nisma për Ndryshim Shoqëror” (ARSIS) ka ndihmuar familjen B në paketa ushqimore dhe higjieno-sanitare¹⁰. Në kuadër të ndihmës së ofruar për familjen B, referuar kontratës së qirasë mes ankueses dhe shteteasit Z. B, të nënshkruar prej palëve me datë 20.02.2020, është mundësuar pagesa e banesës për një afat një vjeçar (nga data 10.01.2020-09.01.2021) me një çmim mujor të qirasë prej 13 000 lekësh. Ankuesja përfitonte gjithashtu 12 000 lekë në muaj nga pagesa e statusit të jetimit.

Nga aktet e dosjes evidentohet se, me datë 03.02.2021 është realizuar mbledhja e Grupit Teknik Ndërsektorial (GNT) në të cilën është diskutuar lidhur me menaxhimin e rastit të familjes B, ku dhe u hartua një PIM një mujor për fuqizimin e familjes.

Mirëpo më pas, ankuesja është larguar për në Berat, dhe rasti i është referuar strukturave të Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë Berat.

Më datë 02.06.2021, ankuesja është paraqitur pranë punonjësës së Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Njesisë Administrative nr. 8, dhe dosja e saj është rihapur sërish.

Bazuar në procesverbalin e takimit të datës 02.06.2021, rezulton se është mbajtur një takim i Grupit Multidisiplinar, për fëmijët e znj. B, takim i cili ishte thirrur nga Specialistja për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njesisë Administrative nr. 8 dhe pjesë e të cilit ishin, përfaqësues të: Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të Qendrës Komunitare Multidisiplinare, shoqatave të ndryshme, si: ARSIS, Qendrës “Për të Drejtata e Gruas Rome”, SHKEJ.

Në këtë GTN u rivlerësuan kushtet social-ekonomike të familjes dhe u dol me vendimin:

- *Do mundësohet regjistrimi i znj. B si shitëse ambulante - Qendra “Për të Drejtata e Gruas Rome”.*
- *Rishikimi i mundësisë për të nënshkruar kontratë huapërdorimi ose gjetjen e një shtëpie me kontratë qiraje - Qendra “Për të Drejtata e Gruas Rome”.*

¹⁰ Referuar procesverbalëve të nënshkruar mes ankueses dhe përfaqësuesve të ARSIS.

- *Mbështetje me pagesën e rrugës për të takuar fëmijët në institucion- Qendra “Për të Drejtat e Gruas Rome”.*
- *Monitorim i vazhdueshëm - Nisma, PMF i njësisë 8.*
- *Pas zbatimit të planit në varësi të vlerësimeve do të ndërmerren hapa të mëtejshëm për rikthimin e fëmijëve në familje.*

Referuar të dhënave dhe historikut të familjes B, të dokumentuara gjatë hetimit, (nga viti 2017 dhe deri aktualisht) rezulton se ankuesja dhe fëmijët e saj janë zhvendosur herë pas here duke ndryshuar vendbanimin e tyre si brenda territorit të Bashkisë Tiranë (në njësi administrative të ndryshme), ashtu edhe nga Tirana në qytete të ndryshme, si Berat dhe Shkodër, ku ka qëndruar për periudha jo shumë të gjata kohore.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjen të bazuar pretendimin e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë lidhur me vështirësitë e hasura prej tyre për monitorimin dhe menaxhimin e rastit të familjes B, pikërisht për shkak të ndryshimit të herëpashershëm të vendbanimit të tyre.

Dokumentohet interesimi i strukturave përgjegjëse të njësive administrative pranë Bashkisë Tiranë, pasi ato kanë referuar dhe ndjekur rastin e familjes B edhe kur ankuesja është zhvendosur nga qyteti i Tiranës për në Berat apo Shkodër, duke ia komunikuar rastin dhe të dhënat e familjes punonjësve sociale të bashkive respektive ku ajo ka vajtur.

Menaxhimi i rasteve bazohet në një metodologji e cila siguron hap pas hapi ofrimin e vazhdueshëm dhe efektiv të ndihmës për individët në nevojë, qofshin këta të rritur, fëmijë apo dhe familje, në mbrojtje të të drejtave dhe mirëqënies së të tyre.

Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë njësisë administrative përkatëse, në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, si dhe VKM nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, për hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, kryen funksionin e menaxherit të rastit, që nga momenti i identifikimit dhe referimit të tij, gjatë hartimit dhe zbatimit të masës së mbrojtjes, deri në përfundimin e saj.

Në përmbushje të detyrave sa më sipër, në kuadër të marrjes së masave që fëmijët të mos qëndrojnë në rrugë, Bashkia Tiranë ka ngritur strukturat përgjegjëse për parandalimin , mbrojtjen, fuqizimin dhe riintegrimin e fëmijëve në situatë rruge dhe famijeve të tyre.

VKM nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, për hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, parashikon mënyrën e rregullimit të menaxhimit të rasteve të tilla, fillimisht përmes hartimit dhe përmbajtjes së PIM (Planit Individual të Mbrojtjes) siç është dhe rasti i familjes B, ku parashikohen disa ndërhyrje dhe shërbime kryesore¹¹.

¹¹ Shprehimisht: Vizita në familje dhe vlerësime psikologjike, sociale dhe ekonomike;

- Mbështetje me paketa ushqimore, veshmbathje, paketa higjeno-sanitare;
- Pagesë qiraje, lidhja e kontratave noteriale;
- Medikamente;

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar veprimet e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor lidhur me detyrimin e tyre për të respektuar dhe përmbushur të drejtat ligjore të subjektit ankues për mbështetje dhe marrje masash efektive për fuqizimin e familjes së saj, në mënyrë që ajo të ketë mundësi reale për të rimarrë fëmijët nga institucionet e përkujdesjes alternative.

Përsa i takon vendimmarrjes së Gjykatës, (*referuar vendimit të datës 25.01.2019, të Gjykatës ë Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë*) lidhur me vlerësimin si të ligjshëm të masës së mbrojtjes të marrë me vendimin nr. 2468/1 prot., datë 17.01.2019, nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Tiranë “Masë e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative”, pranë një institucioni rezidencial të përkujdesjes për fëmijët M, N dhe F. B; si dhe vendosjes së fëmijëve në përkujdesje alternative pranë Shtëpisë së Foshnjës Vlorë dhe Shtëpisë së Foshnjës Sarandë, e heqjen e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të P. B gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes së konfirmuar nga gjykata; Komisioneri gjykon se, nuk është kompetencë e tij të vlerësojë nëse vendimmarrja është e drejtë dhe nuk ka shqyrtuar një fakt të tillë, pasi vendimmarrjet e gjykatave i nënshtrohen vetëm shqyrtimit të shkallës më të lartë.

Por, Komisioneri ka analizuar hapat e procedurën e ndjekur nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, lidhur me menaxhimin e këtij rasti, konform parashikimeve në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, përsa i takon detyrimeve të organeve shtetërore për menaxhimin dhe fuqizimin e familjeve vulnerabël, dhe konkretisht të familjes B, në mënyrë që fëmijët të mund të ktheheshin tek familja e tyre biologjike. Pra, lidhur me sa më sipër, Komisioneri ka analizuar masat e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, pas datës 25.01.2019 (*pas daljes së vendimit të gjykatës*) në kontekst të fuqizimit të familjes së ankueses.

Ligji nr. 18/2017 “*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohen parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ligji përcakton se: “2. *Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.*”

-
- Ndërmjetësim për punësim;
 - Shërbim psiko-social;
 - Ndihmesë në përgatitjen e dokumentave për bonus qiraje;
 - Ndërmjetësim dhe asistim në kryerjen e vizitave mjekësore;
 - Regjistrim në çerdhe, kopshte, shkolla, regjistrim në gjendjen civile;
 - Shërbim ligjor falas.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysht:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysht situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore”.

Neni 9¹², i Ligjit parashikon se:

“1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

2. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

5. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditar të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast. Ky kriter ndiqet nga gjykata edhe në përcaktimin e kontakteve të fëmijës me persona të tjerë të afërt me të.

6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;

b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;

c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;

ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;

¹² “E drejta për të qëndruar me prindërit”

- d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;
- dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;
- e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

.....

10. Në rast se prindërit nuk bien dakord për vendbanimin e fëmijës, gjykata vendos për vendbanimin e tij, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe mban në konsideratë:

- a) vullnetin e secilit prind për të përfshirë prindin tjetër në vendime që lidhen me fëmijën dhe të mbikëqyrë të drejtat prindërore të tjetrit;
- b) historikun e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe secilit prind, duke përfshirë masën dhe mënyrën se si i kanë plotësuar detyrimet prindërore secili prej tyre kundrejt fëmijës;
- c) vullnetin e secilit prind për të lejuar tjetrin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;
- ç) statusin e banesës të secilit prind në 3 vitet e fundit;
- d) historikun e veprimeve të dhunshme ndaj fëmijës ose ndaj personave të tjerë;
- dh) distancën ndërmjet banesës së secilit prind dhe institucioneve të edukimit që ndjek fëmija;
- e) mendimin e fëmijës;
- ë) vendbanimin e motrave dhe vëllezërve të fëmijës.

11. Këto aspekte mbahen parasysh edhe në rastet kur vendbanimi i fëmijës caktohet pranë institucioneve të tjera të rritjes dhe edukimit ose në rast të mbrojtjes që i ofrohet fëmijës në nevojë për mbrojtje”.

Neni 22, i Ligjit, “ E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror”, përcakton se:

- “1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.
- 2. Në rast se prindi/prindërit ose personi/ personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkaqe që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.
- 3. Çdo institucion publik ose jopublik që ushtron aktivitet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës ka detyrimin t’u japë prindërve të gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi”.

Ky Ligj ka parashikuar gjithashtu, se: “Prindi ose kujdestari ka detyrimin t’i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se

qëndrimi i mëtejshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj”¹³.

Ndërsa, neni 31 “Përkujdesja alternative”, parashikon se:

“ 1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.

2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës;

b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën;

c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.

3. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje, sipas nenit 55 të këtij ligji.

4. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes”.

Ligji përcakton se, mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor¹⁴, duke specifikuar se, strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:

a) bashkia;

b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësite administrative;

d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të

¹³ Neni 30 “Ushtrimi i kujdesit prindëror”.

¹⁴ Neni 34 “Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës për¹⁵:

- a) marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe të grupit teknik ndërsektorial;
- b) miratimin dhe koordinimin e veprimeve ndërsektoriale me institucionet shtetërore për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes;
- c) marrjen e masave për koordinimin me njësitë përkatëse brenda bashkisë për realizimin e prokurimit të shërbimeve të nevojshme për realizimin e Planit Individual të Mbrojtjes, kur ato nuk mbulohen dot nga strukturat shtetërore;
- ç) marrjen e masave për organizimin dhe planifikimin e një shërbimi mbrojtjeje emergjente 24-orësh, i cili i njoftohet edhe strukturave të Policisë së Shtetit;
- d) monitorimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e garantimin e aksesit në të drejtat e fëmijës në territorin e bashkisë;
- dh) raportimin për ecurinë e veprimtarisë së njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe për situatën e fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

2. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës miraton, me udhëzim, mënyrën e vendosjes, në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën, ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës në Bashki¹⁶ ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përveç detyrave të parashikuara në nenin 51, të këtij ligji, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

- a) të mbështesë punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;
- c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;

¹⁵ Neni 48, “Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore”

¹⁶ Neni 49, “Njësia për mbrojtjen e fëmijës”

ç) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësisive administrative përkatëse;

d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;

dh) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;

e) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/ komunës;

ë) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrin të Drejtësisë.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.

Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkive¹⁷ janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës¹⁸ kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:

“a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;

b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;

ç) të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;

¹⁷ Neni 50, Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të Bashkisë

¹⁸ Neni 51 Detyrat e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës

d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;

dh) të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes. Profesionistët e tjerë, të përfshirë në zbatimin e masës së mbrojtjes apo të Planit Individual të Mbrojtjes, janë të detyruar ta mbajnë të informuar punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në lidhje me progresin, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të tyre;

e) të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës dhe/ose është në interesin më të lartë të tij;

ë) të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në përmbushjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;

f) të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;

g) t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës....”.

Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja e mbrojtja e prindërve ose kur, për shkak të interesit të tij më të lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve¹⁹.

Monitorimi i masave të mbrojtjes²⁰ për fëmijët, bëhet nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili është përgjegjës për monitorimin e masave të mbrojtjes së fëmijës. Ai duhet të raportojë te drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, të paktën një herë në muaj, për mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj²¹.

¹⁹ Neni 53

²⁰ Neni 60

²¹ “ 2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës i dërgon propozimin për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familjen e tij drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, duke e shoqëruar atë edhe me dokumentacionin përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje nuk do ta ekspozojë atë në ndonjë rrezik të mundshëm për jetën dhe integritetin e tij fizik, psikologjik moral apo emocional. 3. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin për heqjen e masës mbrojtëse, autorizon punonjësin për mbrojtjen e fëmijës për të paraqitur kërkesën për heqjen e masës mbrojtëse, nëse ajo është konfirmuar nga gjykata kompetente. 4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë ndonjë veprim tjetër, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshin informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse”.

Neni 61, parashikon masat për aftësim prindëror që duhen ndërmarrë nga struktura përgjegjëse e Bashkisë, që është Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë ose me njësinë për vlerësimin dhe referimin e rastit në nivel njësie administrative, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtjeje të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.

Plani për aftësim prindëror mund të përmbajë masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës ekonomike, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj. Zbatimi i planit për aftësimin prindëror ndiqet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me punonjësit e njësisë së vlerësimit dhe referimit të rasteve.

Ligji nr. 126/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Ky ligj përcakton:

a) llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

b) rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij²².

Në kuptim të këtij Ligji, termi “Shërbime të kujdesit shoqëror” nënkupton dhe përfshin një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Parimi i mbështetjes shoqërore, sipas këtij Ligji, parashikon se, “*Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë*”.

Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t’i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat

²² Neni 2, i Ligjit.

e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.

Ligji, në nenin 36, të tij, ka përcaktuar rolin e Bashkisë, duke specifikuar se:

“ 1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj:

- a) duke identifikuar nevojat;*
 - b) duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;*
 - c) duke hartuar planin social vendor;*
 - ç) duke programuar buxhetet vendore;*
 - d) duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;*
 - dh) duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;*
 - e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.*
- 2. Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror.*
- 3. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.*
- 4. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.*
- 5. Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.”.*

Ligji, në nenin 37, të tij, ka përcaktuar gjithashtu, rolin e punonjësimit social të njësisë së qeverisjes vendore /Bashkisë, duke specifikuar shprehimisht se:

“Punonjësimit socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:

- a) të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve;*
- b) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;*
- c) të marrin pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit;*
- ç) të përgatitin dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak;*
- d) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;*
- dh) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë”.*

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ka për qëllim të përcaktojë rregullat dh procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 11, të tij, ky Ligj ka parashikuar llojet e programeve sociale të strehimit, si më poshtë citohet:

“1.Në programet sociale të strehimit përfshihen:

- a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;*
- b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;*
- c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;*
- ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehim;*
- d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;*
- dh) programi i banesave të specializuara.*

2.Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore”.

Rregullat e përgjithshme për aplikimin në programet sociale të strehimit, janë përcaktuar në nenin 14 të Ligjit, konkretisht:

“1.Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/ vendqëndrimit të aplikantit. 2.Individi/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë. 3.Dokumentacioni për të përfituar strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Ndërsa, kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, përcaktohen në nenin 16 të Ligjit, si më poshtë:

“Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi.....

... xi) anëtarët e komunitetit rom dhe anëtarët e komunitetit egjiptian”.

Neni 29, i ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, “Lidhja e kontratës së qirasë”, ka specifikuar si më poshtë se:

“1. Kontrata e qirasë lidhet ndërmjet pronarit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij dhe, sipas rastit, individit përfitues ose, në rastin e familjeve, prej bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.

2. Kontrata e qirasë lidhet me të drejtë ripërtëritje çdo vit, bazuar në dokumentimin zyrtar që vërteton të ardhurat e çdo individi të familjes.

3. Vërtetimi i të ardhurave, sipas rastit, merret nga qendra e punës ose personi juridik apo fizik që e ka punësuar, ose zyra përkatëse e ndihmës sociale pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, apo Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Në rastin e individëve pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta, shpenzimet për lidhjen e kontratës së qirasë përballohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Me lidhjen e kontratës, qiramarrësi është i detyruar të paguajë një paradhënie, në formë garancie, në vlerën e një qiraje mujore. Vlera e garancisë zbritet nga qiraja e muajit të fundit të afatit të qirasë, përveç rasteve kur ajo duhet të përdoret për riparimet e nevojshme të banesës, të diktuar nga dëmtimi i saj nga qiramarrësi ose përveç rasteve kur palët në kontratën e qirasë kanë parashikuar ndryshe. Për familjet pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulëta, paradhënia paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e cila kryen subvencionimin e qirasë për këto kategori”.

Lidhur me parashikimin e mundësisë së zgjidhjes së kontratës së qirasë nga qiradhënësi para afatit, Ligji ka përcaktuar se:

“1.Kontrata e qiramarrjes zgjidhet nga qiradhënësi, në mënyrë të njëanshme, para përfundimit të afatit të kontratës, nëse:

a) qiramarrësi bën deklaram të rremë për të ardhurat;

b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;

c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti;

ç) qiramarrësi, pa arsye të justifikuar, nuk ka paguar qiranë për 3 muaj rresht;

d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 19, të këtij ligji.

2.Qiradhënësi duhet të njoftojë me shkrim qiramarrësin para zgjidhjes së kontratës, sipas kushteve dhe në adresën e përcaktuar në kontratën e qirasë.

3.Pas zgjidhjes së kontratës, qiramarrësi është i detyruar të bëjë lirim të banesës dhe t’ia dorëzojë pronarit në gjendjen dhe me inventarin që e ka marrë në dorëzim.

4.Në rast se qiramarrësi nuk përmbush detyrimet sipas shkronjës “ç”, pikës 1, të këtij neni, për shkaqe të tilla si: shpenzime të arsyeshme shëndetësore, papunësi e menjëhershme ose humbje e një pjesëtari të familjes, që siguronte të ardhurat dhe këto arsye nuk ndryshojnë me kalimin e tre muajve, qiramarrësi kalon në një nga programet e tjera të strehimit social. Detyrimet e pashlyera për tre muajt e fundit mbulohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore”.

Neni 65, i këtij Ligji ka përcaktuar se:

“1.Mbështetja nga buxheti i shtetit dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore për përfituesit nga programet sociale të strehimit jepet pas verifikimit të gjendjes ekonomike e financiare të familjes.

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Në analizë të situatës faktike dhe ligjore, lidhur me rastin në shqyrtim, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë (*evidentuar më sipër në vendim nominalisht*) përsa i takon monitorimit dhe menaxhimit të rastit të familjes B, situata e saj mbetet e pa zgjidhur. Në këtë kontekst, konstatohet se:

- Ankuesja është ndihmuar në mënyrë të herëpashërëshme me paketa ushqimore, higjieno-sanitare, medikamente, pagesë disa mujore të qirasë së banesës etj, gjë e cila është mundësuar edhe në bashkëveprim me shoqata të ndryshme, të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e përkohshëm të jetesës së saj.
- Pavarësisht faktit se nga strukturat e Bashkisë është pretenduar se ankuesja është orientuar për t'u regjistruar në kurse profesionale apo i është ofruar ndonjë mundësi punësimi por ajo e ka refuzuar; Bashkia nuk ka faktuar me dokumentacion një pretendim të tillë.
- Nuk provohet që nga ana e Bashkisë ankueses t'i jetë siguruar një mundësi konkrete punësimi, përveç një momenti kur asaj i është krijuar një mundësi punësimi duke shitur rroba të përdorura (*mundësi kjo e krijuar nga strukturat e Bashkisë në bashkëpunim me shoqata të ndryshme*).
- Ankuesja me datë 17.01.2022, i është drejtuar shkresërisht SHSSH dhe Bashkisë Tiranë, duke i informuar lidhur me situatën e saj ekonomike, përpjekjet për të përmirësuar jetesën dhe ka kërkuar që t'i rikthehen fëmijët. Ajo i ka informuar se, që nga fillimi i muajit dhjetor 2021, është punësuar pranë kompanisë së pastrimit "Fusha", se bashkëjeton me babain biologjik të fëmijëve, i cili është i punësuar pranë kompanisë së pastrimit "Sharrë" dhe se bashkarisht jetojnë në një banesë me qira në Selitë. Gjithashtu, ankuesja informon se gjetja e një shtëpie me kontratë të rregullt qiraje është e vështirë për ta, pasi pronarët nuk bien dakord me këtë gjë, për faktin se ata janë romë.
- Lidhur me argumentin e dhënë nga Bashkia se, një ndër kriteret për përfitimin e të drejtës për t'u trajtuar me bonus qiraje, është që ankuesja duhet të depozitojë dhe një kontratë qiraje paraprakisht, Komisioneri vlerëson se, nuk qëndron dhe është i pambështetur në ligj.
- Komisioneri gjen të pabazuar pretendimin e Bashkisë, për depozitim paraprak të kontratës së qirasë së banesës nga ankuesja, në kushtet kur vetë insitucioni i Bashkisë, në faqen zyrtare të tij²³, në aktet e publikuara lidhur me kriteret që duhen plotësuar nga aplikuesit, për përfitimin e bonusit të qirasë, nuk e kërkon në mënyrë të detyrueshme një dokument të tillë. Kështu tek faqja zyrtare e web-it të Bashkisë, është publikuar lista me dokumentacionin e kërkuar, duke specifikuar ndër të tjera se, kërkohet:
".....Kontrate qiraje nëse e disponon".
- Për më tepër, kuadri ligjor dhe nënligjor sipërcituar, ka përcaktuar në mënyrë të qartë se detyrimi për mbulimin e kontratës së qirasë, për rastin konkret të ankueses, në kushtet e pamundësisë ekonomike dhe në kuadër të fuqizimit të familjes së saj për rimarrjen e fëmijëve nga institucionet e kujdesit të përkohshëm, është i Bashkisë Tiranë dhe strukturave përgjegjëse të saj.

²³ <https://tirana.al/sherbimi/strehimi>

- Bashkia Tiranë nuk dëshmoi me fakte e prova se ka marrë masa konkrete, *(megjithëse Komisioneri i la kohë të mjaftueshme, duke cituar këtu edhe vendimin e KMD-së për zgjatje të afatit të shqyrtimit të çështjes, pikërisht në kuadër të masave që ata duhet të ndërmerrenin për rregullimin e situatës së familjes B)* për të rikonsideruar mundësitë reale, kryesisht për punësimin dhe strehimin e familjes B, lidhur me fuqizimin e familjes për rimarrjen e fëmijëve sërish pranë familjes biologjike.

Komisioneri vlerëson përpjekjet dhe bashkëpunimin e strukturave të Bashkisë dhe me faktorë të tjerë të jashtëm institucionalë, siç janë edhe shoqatat e ndryshme, por evidenton se detyrimi ligjor për të ndikuar në fuqizimin e familjes së ankueses, përmes mundësive konkrete të punësimit dhe përfutimit nga programet sociale, është i Bashkisë. Kjo, e parë edhe në kontekst të parimit të interesit më të lartë të fëmijëve, pasi argumenti i dhënë nga përfaqësueset e strukturave të Bashkisë Tiranë, lidhur me pretendimin e ankueses për rimarrjen e fëmijëve nga institucionet e kujdesit të përkohshëm, ka qenë vetëm në kontekst të përmirësimit të kushteve të jetesës së familjes, në mënyrë që, nëse fëmijët do të riktheheshin pranë familjes biologjike të kishin kushte normale jetese dhe banimi. Pra, plotësimi i këtyre kushteve është njëherësh edhe parakushti që duhet plotësuar për të iniciuar procedurën për rimarrjen e fëmijëve para gjykatës.

Lidhur me vlerësimin në tërësi të të gjithë faktorëve që duhen plotësuar, nëse fëmijët duhet të rikthehen pranë familjes biologjike apo jo, mbetet në vendimarrjen e gjykatës, por, Komisioneri vlerëson se, në mënyrë që ankuesja të mund t'i drejtohet qoftë edhe formalisht gjykatës, duhet të ketë plotësuar paraprakisht kriteret e kërkuara, për të cilat ajo ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret, detyrimi dhe përgjegjësia ligjore për fuqizimin real të kësaj familjeje i mbetet Bashkisë Tiranë.

Nga analizimi i situatës, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve objekt hetimi, rezulton se, Bashkia Tiranë, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme subjektin ankues, në raport me të drejtat e saj ligjore, si dhe nuk ka përmbushur detyrimin ligjor, në kuadër të fuqizimit të familjes biologjike të saj, përse i takon punësimit dhe strehimit.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2²⁴, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

²⁴ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtetësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.

B/1 Raca, etnia

Subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim për shkak të “racës” dhe “etnisë”.

Referuar dokumentit, Vërtetim i datës 01.06.2021, lëshuar nga organizata “Qendra për të Drejtat e Gruas Rome”, ankuesja rezulton se është anëtare e minoritetit Rom të Shqipërisë.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, këto shkaqe të pretenduara nga subjekti ankues konsiderohen si shkaqe të mbrojtur, pasi parashikohen si të tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Përkufizimi më gjerësisht i pranuar mbi racën është ai i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Gjithë Formave të Diskriminimit Racor. Në nenin 1, kjo Konventë definon diskriminimin racor si çdo dallim, përjashtim ose privilegjim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës ose origjinës nacionale ose etnike, që ka për qëllim pamundësimin ose vështirësimin të pranimit, gëzimit apo ushtrimit të bazës së barabartë të të drejtave dhe lirive bazë të njeriut në fushën e jetës ekonomike, shoqërore, kulturore, si dhe fusha tjera të jetës publike²⁵. Në kontekstin rajonal evropian, me rëndësi është përkufizimi i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe tolerancës (ECRI), sipas së cilit, racizmi dhe diskriminimi racor lidhen me bazat racë, ngjyrë të lëkurës, fe, nacionalitetet ose origjinë nacionale ose etnike²⁶.

Përkatësia etnike shpesh konsiderohet si pjesë e diskriminimit racor. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK) konsideron përkatësinë etnike si shkak të mbrojtur për diskriminim, dhe si pjesë të mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të racës dhe ngjyrës së lëkurës²⁷. Sipas GjEDN-së, përkatësia etnike nxjerr origjinën nga idea mbi grupet shoqërore,

²⁵ Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor. Neni 1

²⁶ ECRI General policy recommendation No. 7 on national legislation to combat racism and racial discrimination. Council of Europe Website. <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation_n7/ecri03-8%20recommendation%20nr%207.pdf>.

²⁷ Komenti i përgjithshëm nr. 20 i Komitetit për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. parag.19

tipari kryesor i të cilave është origjina e përbashkët nacionale, lidhshmëria me një fis të caktuar (ang. tribe), bindje fetare, gjuhë të përbashkët, ose origjinë dhe prapavijë kulturore dhe tradicionale²⁸.

GJEDNJ-ja në çështjen Timishev kundër Ruisë , ka mbajtur qëndrimin se:

“Përkatësia etnike dhe raca janë koncepte të lidhura dhe të mbivendosura. Megjithëse nocioni i racës është i rrënjësuar në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie sipas karakteristikave morfologjike të tilla si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës, përkatësia etnike e ka origjinën e vet në idenë e grupeve shoqërore të shënuar nga kombësia e përbashkët, përkatësia fisnore, besimi fetar, gjuha e përbashkët, ose origjina dhe prejardhja kulturore dhe tradicionale²⁹”

Bazuar në analizimin sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar nga ankuesja, shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “racës”.

B/2 Gjendja ekonomike

Subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim dhe për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Referuar akteve të depozituara nga ankuesja, rezulton se ajo dhe familja e saj është në pamundësi ekonomike, pa punë dhe pa banesë, fakt i pranuar edhe nga subjekti publik kundrejt të cilit ajo është ankuar³⁰.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova dhe fakte të cilat faktojnë se e mbart atë.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar nga ankuesja, shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “gjendjes ekonomike”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

²⁸ Timishev v Russia (2007) 44 EHRR 776. para.55

²⁹ GJEDNJ, *Timishev kundër Ruisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragraf 55 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, para. 55).

³⁰ Referuar periudhës kohore -objekt shqyrtimimi dhe analizimi nga KMD.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues me shkaqet: racën dhe gjendjen ekonomike, nga ana e Bashkisë Tiranë.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e Bashkisë Tiranë, në raport me parashikimet ligjore të posaçme, dhe të drejtën për të përfituar nga to, bazuar pikërisht në shkaqet që posedon, atë të “racës” dhe të “gjendjes ekonomike”.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se:

“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor³¹.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

³¹³¹ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Ndalimi i diskriminimit garantohet nga neni 14 i KEDNJ-së³², i cili garanton trajtimin e barabartë në gëzimin e të drejtave të tjera të përcaktuara në Konventë. Protokollit 12 (2000) i KEDNJ-së, e zgjeron fushëveprimin e ndalimit të diskriminimit me anë të garantimit të trajtimit të barabartë në gëzimin e të gjitha të drejtave (duke përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar). Në përputhje me Raportin Shpjegues të Protokollit, ai u krijua nga dëshira për forcimin e mbrojtjes nga diskriminimi, që konsiderohej të formonte një element bazë për garantimin e të drejtave të njeriut. Protokollit lindi nga debatet për forcimin e barazisë gjinore dhe raciale në veçanti³³.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Mbrojtja nga diskriminimi në sferën e aksesit tek mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë strehimin, zbatohet edhe në rastin e racës nëpërmjet Direktivës për Barazinë Raciale, miratuar në vitin 2000. Kjo Direktivë, e cila ndalon diskriminimin për shkak të racës ose etnisë në kontekstin e punësimit, por gjithashtu në përfshirjen tek sistemi i ndihmës sociale dhe sigurimeve shoqërore, si dhe mallrat dhe shërbimet.

³² Një guidë trajnimi si prezantim me Power Point që ofron udhëzime për zbatimin e Nenit 14 të KEDNJ-së mund të gjendet në faqen e Internetit të Këshillit të Evropës për Edukimin e Profesionistëve Ligjorë me të Drejtat e Njeriut: www.coehelp.org/course/view.php?id=18&topic=1..

Direktiva për Barazinë Raciale nuk e përkufizon strehimin. Megjithatë, sugjerohet se kjo duhet të interpretohet në dritën e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, në veçanti e drejta për respektimin e shtëpisë sipas nenit 7 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore dhe Nenit 8 të KEDNJ-së, dhe e drejta për strehim të përshtatshëm sipas nenit 11 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Social Kulturore. KEDNJ ka interpretuar të drejtën për të pasur shtëpi gjerësisht që të përfshijë shtëpitë e lëvizshme si p.sh. karvanët ose shtëpitë e rimorkiueshme, edhe në situata kur ato ndodhen ilegalisht³⁴.

Në përputhje me Komitetin Evropian për të Drejtat Ekonomike Social Kulturore (KEDS), strehimi i përshtatshëm duhet të plotësojë një sërë kriteresh, dhe në veçanti duhet: të jetë me cilësi të mjaftueshme për garantimin e mbrojtjes nga elementët, duhet të reflektojë kriteret kulturore të banorëve (dhe të përfshijë automjetet, shtëpitë e rimorkiueshme, kampet dhe struktura të tjera jo të përhershme), të jetë e lidhur me shërbimet e ujësjellës kanalizimeve, dhe të jetë e lidhur me shërbimet publike dhe mundësitë për punësim nëpërmjet një infrastrukture të përshtatshme. Duhet të përfshijë gjithashtu mbrojtjen e përshtatshme kundër dëbimeve me forcë, dhe të jetë e përballueshme financiarisht³⁵.

Në rastin *European Roma Rights Centre kundër Portugalisë*, KEDS-ja kishte vërtetuar ekzistimin e diskriminimit në lidhje me të drejtën e mbrojtjes sociale, juridike dhe ekonomike të familjeve, të drejtën e mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimit social dhe të drejtën e banimit përkatës (n. 16, 30 dhe 31 nga MSE-ja)³⁶.

Raporti i ECRI-i për Shqipërinë³⁷, i datës 7 prill 2020, përsërit rekomandimin e tij që, autoritetet përgjegjëse shtetërore duhet të sigurojnë që të gjithë romët dhe egjiptianët, si çdo person tjetër, të gëzojnë të gjitha garancitë që parashikojnë aktet ligjore ndërkombëtare në lidhje me strehimin.

Në veçanti, ata duhet të të përfitojnë nga mbrojtja e duhur ligjore dhe të kenë mundësinë e strehimit në një banesë të përshtatshme.

Raporti në pikat 53 dhe 54, të tij evidenton se:

“Situata e strehimit është ende jashtëzakonisht e vështirë për shumë romë dhe egjiptianë në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të dobëta, mungesa e përhapur e titujve të pronësisë ose marrëveshjeve të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Me rritjen e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, romët dhe egjiptianët që jetojnë në banesa joformale kanë qenë nën presion për t’i braktisur vendbanimet e tyre, në disa raste duke u dëbuar shumë herë nga vende të ndryshme, pa qasje të lehtë në zgjidhje alternative dhe të përhershme të

³⁴ GJEDNJ, *Bakli kundër M.B* (Nr. 20348/92), 25 Shtator 1996 (ECtHR, *Buckley v. UK* (No. 20348/92),

³⁵ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Social Kulturore, “Koment i përgjithshëm Nr.4: e drejta për strehim të mjaftueshëm (Neni 11 (1))” Dokumenti i Kombeve të Bashkuara E/1992/23, 13 Dhjetor 1991.

³⁶ Komiteti kishte vlerësuar se kishte munguar reagimi përkatës i shtetit, dhe me këtë dhe se ekziston diskriminimi që ka si bazë përkatësinë etnike. Një gjykim të këtillë Komiteti kishte sjellë dhe në rastin *COHRE kundër Italisë*.

³⁷ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-ECRI-t-për-Shqipërinë.pdf>

strehimit. Duke pasur parasysh që kërkesa e përgjithshme për strehim social në vend tejkalon ofertën, kjo zakonisht nuk është një zgjidhje e menjëhershme, përveç një numri të vogël të personave të prekur. Sidoqoftë, shumë romë dhe egjiptianë preferojnë, ose edhe insistojnë, të qëndrojnë së bashku në grupet e tyre të krijuara, të cilat jo vetëm që përbëjnë një identitet kulturor për ta, por janë edhe rrjete të rëndësishme mbështetëse për të përballuar më mirë varfërinë dhe efektet e marginalizimit shoqëror.

Në raportin e tij të mëparshëm, ECRI rekomandoi që:

- (i) autoritetet të forcojnë përpjekjet e tyre për të rregulluar strehimin e paligjshëm për romët dhe egjiptianët;
- (ii) (ii) personat e dëbuar nga shtëpitë e tyre të gëzojnë të gjitha garancitë e dhëna nga standardet përkatëse ndërkombëtare (njoftim paraprak, mbrojtje të përshtatshme ligjore, disponueshmëri të banesave alternative);
- (iii) (iii) akses me përparësi për strehim social, duke u reformuar në mënyrë që të përfshijë më mirë personat e prekur nga prishja e banesave/dëbimeve”.

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata, në qëndrimet e saj ka qenë jashtëzakonisht e rreptë në lidhje me diskriminimin për shkak të racës ose përkatësisë etnike duke u shprehur se: “Asnjë diferencë në trajtim, që bazohet ekskluzivisht ose në një masë vendimtare tek përkatësia etnike e një personi nuk mund të përlligjet objektivisht në një shoqëri demokratike bashkëkohore, të ndërtuar në parimet e pluralizmit dhe respektit për kulturat e ndryshme”.

Detyrimi ligjor i organeve shtetërore dhe e drejta për të përfituar nga parashikimet e mësipërme ligjore, për kategorinë e individëve që i përkasin minoriteteve të caktuara (për shkak të etnisë dhe racës së tyre) të cilët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sociale, ekonomike, juridike, etj, sanksionohet dhe në aktet ligjore e nënligjore kombëtare, në të njëjtën frymë si në aktet ndërkombëtare sipërcituar.

Kështu, sikurse Komisioneri ka analizuar në pjesën A.1, të këtij vendimi³⁸, kuadri ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka përcaktuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, (të cilat, pavarësisht hierarkisë ekzistojnë dhe veprojnë në harmoni institucionale, si një e tërë), për sa i takon menaxhimin të rastit të ankueses për fuqizimin real të familjes së saj, në mënyrë që ajo të mund të rimarrë fëmijët e saj pranë familjes biologjike.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

³⁸ Fq 9-24 e Vendimit.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 3, pika 5 e LMD-së, parashikon se: *“Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas”.*

Neni 20/1/2/4, i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka

transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.³⁹

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për të marrë shërbimin nga ana e Bashkisë Tiranë.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Bashkisë, lidhet me shkaqet e mbrojtura.

Identifikimi i të gjitha shkaqeve të diskriminimit dhe analizimi i tyre në një çështje diskriminimi është mjaft i rëndësishëm, jo thjesht për të performuar diskriminimin e shumëfishtë, por edhe për të dhënë një vendim sa më efektiv. Në çështjen në shqyrtim, Komisioneri ka identifikuar dhe vlerësuar se ankuesja posedon më shumë se një shkak të mbrojtur nga LMD, atë të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës⁴⁰, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar, për fuqizimin e familjes.

Ankuesja ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, përmes mosgarantimit efektiv të së drejtës për punësim dhe strehim, në kontekst të fuqizimit të famijes së saj, megjithëse ligjislacioni sipërcituar, subjekt i të cilit është, ia njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur të drejtën e saj ligjore.

³⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

⁴⁰ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Fakti i posedimit së shkaqeve të mbrojtura nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këto shkaqe, (racë dhe gjendje ekonomike) ata kanë patur në monitorim dhe trajtim rastin e saj.

Lidhur me problematikën e subjektit ankues dhe familjes së saj, Komisioneri vlerëson se:

- Pavarësisht se nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë (*njësitë e mbrojtjes së fëmijëve*) vihet re se ka patur përpjekje të vazhdueshme për të asistuar dhe ndihmuar familjen B (*analizuar më sipër në vendim*), Komisioneri gjykon se, ndihmat e dhëna kundrejt familjes në formën e paketave ushqimore, higjeno-sanitare apo dhe mjekësore, janë një ndihmë e përkohshme, por nuk zgjidhin situatën në vazhdimësi dhe nuk garantojnë siguri financiare dhe sociale tek familja.
- Në këtë këndvështrim, Bashkia, duhet të kishte ndërhyrë me masa konkrete, sikurse përcaktohet nga i gjithë kuadri ligjor në fuqi, përsa i takon ofrimin të mundësisë konkrete për punësim dhe strehim të familjes. Vetëm përmes punësimit dhe sigurimit të një banese të përshtatshme, ankuesja dhe familja e saj mund të krijonin një lloj sigurie e pavarësie, qoftë financiare, qoftë sociale, në mënyrë që të mund të përballonin me punën e tyre dhe më dinjitet jetesën e përditshme, duke krijuar kështu edhe premisat reale për rimarrjen e fëmijëve nga institucionet ku qëndrojnë aktualisht.
- Njëherësh ky do të ishte hapi të parë që ankuesja të mund të iniciojë procedurat para gjykatës për rimarrjen e fëmijëve, pasi nga Bashkia është dhënë si shpjegim se pikërisht mosplotësimi i kushteve të përshtatshme për jetesë nga familja B, përbën dhe pengesën kryesore që ata të iniciojnë para gjykatës procesin për rikthimin e fëmijëve pranë familjes biologjike.
- Në vijim mbetet në vlerësim të gjykatës përmbushja apo jo e kushteve për rikthimin e fëmijëve pranë ankueses dhe famijes së tyre biologjike, por hapi i parë procedural lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me sigurimin e strehimit dhe punësimit të ankueses, në mënyrë që ajo të ketë mundësi reale për iniciimin e kësja procedure.
- Komisioneri vlerëson se, përkundrazi, nga ana e Bashkisë jo vetëm nuk është punuar në mënyrë efektive për fuqizimin e familjes (*as për punësimin e tyre dhe as për krijimin e mundësisë për të përfituar nga programet e strehimit social*), por janë nxjerrë pengesa të panevojshme, duke i kërkuar dokumenta të tepërta dhe të pacilësuar në aktet ligjore apo nënligjore, siç kemi analizuar më lart në vendim, kërkesën nga ana e Bashkisë për dorëzimin e një kontrate qiraje banese, kur kjo kërkesë është fakultative dhe jo e domosdoshme për t'u plotësuar nga aplikanti.
- Për më tepër, ankuesja, duke qenë pjesë e minoriteti rom, duhet të përfitonte asistencën e nevojshme nga të gjitha strukturat përgjegjëse të Bashkisë për të plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar si për punësimin e saj, ashtu dhe për strehimin.
- Komisioneri vlerëson se, Bashkia, nuk ndërmorri asnjë masë konkrete lidhur me problematikën e strehimit të ankueses, edhe pasi ajo kishte informuar shkresërisht atë, për punësimin e saj dhe të babait biologjik të fëmijëve të saj, dhe për mundësinë se aktualisht banojnë në një banesë me qira, të cilën arrijnë ta paguajnë vetë.
- Nuk u sollën fakte e prova nga ana e Bashkisë që minimalisht të tregonin interesimin dhe angazhimin e saj lidhur me verifikimin për sa kishte deklaruar ankuesja apo që të kishte

vlerësuar e analizuar situatën aktuale të ankueses dhe famijes së saj, në mëyrë që të hartonte një relacion apo të dilte në konkluzione lidhur me gjendjen e tanishme.

Në përfundim të analizimit sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Tiranë nuk provoi që kishte përmbushur detyrimet e saj ligjore karshi ankueses, dhe nuk solli një justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv lidhur me masat konkrete që duhet të kishte ndërmarrë për punësimin, strehimin e znj. B, në kuadër të fuqizimit të familjes të saj.

Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore.

Konventa përt të Drejtat e Fëmijës⁴¹ është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës. Disa nga të drejtat kryesore të fëmijëve, sipas Konventës, janë:

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim: të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta. Asnjë prej tyre nuk mund të diskriminohet për shkak gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale, si dhe për çdo shkak tjetër.

E drejta për të jetuar me prindër: çdo fëmijë ka të drejtën të jetojë së bashku me prindërit e tij/saj, të cilët kujdesen për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

Interesi më i lartë i fëmijës: duhet të jetë synimi kryesor në çdo vendim që merret mbi jetën e fëmijës si nga institucionet shtetërore apo ato private, të përkrahjes shoqërore, gjykatat dhe organet administrative e legjislativë. Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën e të Drejtave të Fëmijës duhet t'u sigurojnë mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e nevojshme të gjithë fëmijëve.

Ato angazhohen ta realizojnë këtë duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, kujdestarëve të tyre ligjorë dhe personave të tjerë ligjërisht përgjegjës duke marrë masat e nevojshme legjislativë dhe administrative. Këto shtete gjithashtu, marrin masat e duhura që institucionet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë sipas normave të caktuara nga organet kompetente.

GJEDNJ është shprehur se: *“Fëmijët dhe individë të tjerë të rrezikuar, në veçanti, kanë të drejtën e mbrojtjes nga shteti, në formën e parandalimit efektiv, kundrejt shkeljeve të rënda të integritetit personal⁴²”*.

Në këtë kontekst, Komisioneri nuk analizon dhe vlerëson masën e mbrojtjes dhe caktimin nga ana e gjykatës që fëmijët e ankueses të vendoseshin nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes alternative përkohësisht, por analizon të drejtën e tyre në këndvështrim të interesit më të lartë të fëmijëve, për të qenë me familjen biologjike (*nënë, motrat dhe vëllezërit*), që minimalisht të merret në shqyrtim e të vlerësohet nga ana e gjykatës nëse plotësohen kushtet për rikthimin e tyre pranë familjes.

⁴¹ Kjo konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

⁴² Këshilli i Europës, ‘Drejtësia Ndërkombëtare për Fëmijët’, 2008, p. 71.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve të minoritetit rom dhe për shkak të gjendjes ekonomike apo statusit social, duhet të sigurohet që t’i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit “Për Barazi, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025⁴³”, citon ndër të tjera se:

Plani Kombëtar i Veprimit “Për Barazi, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve, 2021–2025” (këtu e në vijim “PKVBPPRE 2021– 2025”) u përgatit në emër të qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe në konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për çështjet e integritit të romëve dhe të egjiptianëve në Shqipëri. Plani përputhet plotësisht me kornizën e re strategjike rrome të BE-së për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje 2020–2030.

Dokumenti citon se, “dhe me përpjekjet e qeverisë shqiptare dhe organizatave të tjera, të dhënat nga 5 vitet e mëparshme tregojnë se ekzistojnë ende probleme të regjistrimit civil, arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe mbrojtjes sociale. Këto probleme janë edhe më të mëdha kur shtohet stigma sociale aktuale, stereotipat dhe diskriminimi, që për fat të keq janë akoma të pranishme ndaj romëve dhe egjiptianëve. Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t’i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përynjatimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin diskriminues në disa raste nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore”.

Legjislacioni kombëtar ka shumë akte ligjore dhe nënligjore, që prekin të gjitha sferat e jetës së romëve dhe të egjiptianëve, duke përfshirë fusha të ndryshme të politikës, si të drejtat njerëzore, strehimi, arsimit shëndetësia, punësimi dhe aftësimi, mbrojtja sociale, aksesin në drejtësi, regjistrim civil, kultura etj.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025 do të udhëhiqet nga disa parime bazë, ndër të cilat:

“Hartimi i politikave konstruktive, pragmatike dhe jodiskriminuese – Objektivat e përfshirë në Planin e Veprimit synojnë përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve dhe realizojnë vlerat thelbësore të Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, mosdiskriminimin dhe barazinë e mundësive, si dhe zhvillimin ekonomik. Nxijtja e përfshirjes sociale – Aktivitetet e Planit të Veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t’u përdorur nga këto komunitete.

⁴³ Botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 186/2021.

Respektimi i dallimeve – Plani i Veprimt do të respektojë dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. Plani i Veprimt do të trajtojë anëtarët vulnerabël të këtyre komuniteteve, duke njohur faktin që disa romë dhe egjiptianë janë tashmë të integruar në shoqëri

Me miratimin e këtj dokumenti, Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin që gjatë periudhës 2021–2025 të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore të pakicave rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve strategjike dhe duke zbatuar politika të integruara. (Shiko p.sh. OSCE/ODIR (2013) praktikat më të mira për integrimin e romëve (BPRI).

“Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022” evidenton si qëllim të kësaj strategjie hartimin e një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm të gjithë sektorëve nën përgjegjësinë e Bashkisë Tiranë. Në pikën 1.1 të këtij dokumenti citohet se:

“Bashkia Tiranë (BT) ka nevojë të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm sa më të balancuar socioekonomik, kulturor dhe territorial për të udhëhequr gjithë Shqipërinë në rrugën e saj të integritimit Evropian. SZHQBT synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha projektet e BT në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa fusha prioritare”.

Strehimi. Sipas Censurit 2011 në BT-ës rreth 84.22% e familjeve janë pronarë ose duke u bërë pronarë të banesave ky jetojnë. Kjo përqindje është e ulët krahasuar me vendin ku ky tregues është rreth 90.22%. Në BT-ës, sipas Censurit 2011, jetojnë rreth 45.88 % e familjeve qeramarrëse në vend. Rreth 7.91% e familjeve të BT-ës nuk kanë pasur asnjë lloj ngrohjeje në banesat e tyre gjate 2011, rreth 0.3% nuk kanë tualet dhe rreth 1.5 % nuk kanë sistem të furnizimit me ujë. Përqindja e banesave boshe në BT-ës rezultoi 19.9%. Megjithatë ka një numër të madh familjesh rome të pastrehë. Sipas statistikave të BT-së janë rreth 267 familje rome dhe 50 familje egjiptiane.

Programet sociale të strehimit janë “programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekare. Qeveria ka ngritur tre programe sociale strehimi: banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë. Sipas ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ofrimi i strehimit është detyrë e autoriteteve vendore. Konkretisht, neni 72 përcakton se njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat mbajnë përgjegjësi të plotë për kryerjen e funksioneve të tyre...në fushën e urbanistikës, rregullimit të territorit dhe strehimit (ndër të tjera).” Përgjegjësia e ofrimit të strehimit social ndahet midis qeverisë qendrore dhe njësive vendore. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për strehim; krijimin e programeve dhe projekteve afatmesme dhe afatgjata; ofrimin e truallit të lirë për ndërtim; paraqitjen e kërkesave për financime, investime dhe subvencione te qeveria qendrore; zhvillimin dhe administrimin e një inventari të dhënash; përcaktimin e koston maksimale të ndërtimit të banesave; ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira. NJV duhet të krijojë një plan strehimi afatgjatë që të përfshijë burimet financiare, nevojat për strehim dhe, ndër të tjera, numrin dhe llojin e familjeve që do të përfitojnë nga programe të ndryshme strehimi. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat që ka BT për programet sociale të strehimit, çdo njësi vendore duhet të hartojë një plan strehimi afatgjatë që të

përfshijë burimet financiare, nevojat për strehim dhe ndër të tjera, numrin dhe llojin e familjeve që do të përfitojnë nga programe të ndryshme strehimi. Aktualisht priten ndryshime ligjore dhe BT me zyrtarizimin e këtyre ndryshimeve do të hartojë planin. Gjithashtu ka një nevojë urgjente për një sistem të ri për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave lidhur me aplikuesit dhe përfituesit, që jo vetëm do të shërbejë si bazë për njohjen e situatës aktuale por edhe për studime dhe analiza strategjike për të gjithë territorin e BT-së”.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, faktet dhe provat e administruara krijojnë bindjen se, subjekti ankues, mund të jetë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Tiranë, megjithëse posedonte shkaqet e mbrojtura nga ligji, atë të racës dhe gjendjes ekonomike dhe Bashkia ishte në dijeni të plotë të këtij fakti.

Në këto kushte Bashkia, kishte barrën e provës që të provonte, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkaqet e pretenduara, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e subjektit ankues përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, Bashkia Tiranë ka diskriminuar subjektin ankues, lidhur me mosmarrjen e masave efektive për fuqizimin e familjes B, (kryesisht në kuadër të punësimit dhe strehimit) për rimarrjen e fëmijëve sërish pranë familjes biologjike.

Për rrjedhojë Bashkia Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a), dhe nenin 4, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë vendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Tiranë, dhe kjo mund të realizohet, duke ndërmarrë hapat konkretë në përmbushje të qëllimit për fuqizimin e famijes së ankuses. Vetëm në këtë mënyrë asaj i krijohet mundësia reale për të kërkuar gjyqësisht marrjen e fëmijëve nga institucionet e përkujdesjes alternative ku ndodhen aktualisht, dhe e gjithë përgjegjësia e vendimmarrjes i takon gjykatës, e cila vlerëson dhe vendos në respektim të interesit më të lartë të fëmijëve, nëse ato duhen rikthyer pranë familjes biologjike apo duhet të vijojnë të qëndrojnë në institucionet e përkujdesjes alternative.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 5, nenin 7, nenin 20 pika 1, shkronja a), pika 2, shkronja c dhe pika 4, e tij, nenin 32, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shumëfishtë, të subjektit ankues, P. B, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Gjendja ekonomike, raca

Lloji i vendimit: Diskriminim i shumëfishtë